



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës Jugore  
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

Sektori i Rinisë

*Mitrovicë, 19.03.2021*

**Thirrje publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve lidhur me komponentën e pjesëmarrjes dhe fuqizimit të të rinjëve**

**1. Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit** u bënë thirrje të gjitha organizatave jo-qeveritare të Regjistruara në Republikën e Kosovës, të cilat veprojnë në Komunën e Mitrovicës programi i punës i të cilave është i fokusuar në fushën e pjesëmarrjes dhe fuqizimit të rinisë të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet që kontribuojnë në avancimin dhe afirmimin e të rinjve në Kosovë.

**2. OJQ-të** në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projektet/programet e tyre për fushat prioritare në vijim:

- a) Ngritja e kapaciteteve të organizatave rinore, zhvillimi i shërbimeve më kualitative për të rinjtë, dhe mbështetja e profilizimit të organizatave rinore;
- b) Përkrahja e rrjetëzimit dhe bashkëpunimit të të rinjve në aktivitetet rinore rajonale dhe evropiane si dhe zgjerimi i gamës së shërbimeve rinore
- c) Zbatimi i udhëzimeve administrative që dalin nga Ligji për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë.
- d) 31 Maji dita ndërkombëtare kundër duhanit
- e) Zbulimin e talenteve të rinjë në fusha të ndryshme

**3. Organizatat jo-qeveritare** mund të aplikojnë me një projekt që kontribuojnë në **avancimin dhe fuqizimin e sektorit të rinisë** përmes aktiviteteve si më poshtë:

- ✓ Nxitjen e autoriteteve lokale, institucionet publike dhe akterëve tjerë për bashkëpunim me shoqërinë civile në promovimin dhe nxitjen e pjesëmarrjes tek të rinjtë
- ✓ Avancimin dhe promovimin e politikave qeveritare në fushën e fuqizimit të rinisë;
- ✓ Mentorimin dhe trajnimin e organizatave rinore lokale që veprojnë në fushën e rinisë;

- ✓ Përmirësimin e njohurive dhe zhvillimin e aftësive të punonjësve dhe vullnetarëve të organizatave rinore për avokim dhe fuqizimin e të drejtave të rinjve;
- ✓ Inkurajimi i komunikimit të organizatave rinore me publikun, me fokus në informimin e publikut për të drejtat e rinjve;
- ✓ Promovimi i qytetarit aktivë tek të rinjët dhe aktivizmi i të rinjëve në komunitetet që jetojnë;
- ✓ Adresimin e problemeve specifike të të drejtave të rinjve që ndikojnë drejt për së drejti në nxitjen e pjesëmarrjes së të rinjve në politik bërje dhe vendimmarrje;

#### **4. Vlera totale e planifikuar e thirrjes është 7.000,00euro.**

Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për çdo projekt individual është 500,00 euro, ndërsa shuma maksimale për një projekt është 1.500,00 euro.

5. Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë nga data e shpalljes së thirrjes Publike.

6. OJQ-të mund të aplikojnë me më së shumti një (1) projekt në kuadër të kësaj thirrje dhe vetëm në një (1) nga fushat prioritare sipas thirrjes. Periudha e zbatimit të projektit është për 1-4muaj.

Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ-të që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave jo-Qeveritare në Republikën e Kosovës dhe të cilat veprojnë në Republikën e Kosovës para datës së publikimit të thirrjes publike. OJQ-të aplikuese duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në fushën e rinisë përkatësisht të komponentës së pjesëmarrjes. OJQ-të duhet po ashtu të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike.

Para nënshkrimit të kontratës, OJQ duhet të paraqesë prova se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale, si dhe prova se OJQ-ja ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të papaguara, nëse është e aplikueshme.

7. Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat së bashku me Udhëzimet për Aplikantët, janë në dispozicion në faqen e internetit të ofruesit të mbështetjes financiare (<https://kk.rks-gov.net/mitrovica>).

Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen personalisht në zarf të mbyllur, në adresën e mëposhtme:

**Komuna e Mitrovicës**

**Kati i Parë, Zyra Pritëse**  
**Rruga Bedri Gjinaj, 40000 - Mitrovicë**

Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendarin tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në Udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike.

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

8. Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresat: [lule.veseli@rks-gov.net](mailto:lule.veseli@rks-gov.net), [abedin.pllana@rks-gov.net](mailto:abedin.pllana@rks-gov.net), [fahri.jashari@rks-gov.net](mailto:fahri.jashari@rks-gov.net)